

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

16/03/2023

Drejtuar: **OE “Tetra Solutions” sh.p.k**

Adresa: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Pallati 2/1, Ap.2 Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Nr. REF-57417-01-30-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje sistemi financiar, fiskalizim dhe fatura elektronike në Cloud së bashku me integrim me programin EMCS dhe fiskalizimi i faturave për tre vite”, 3 (tre) vite nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **NR. REF-54630-12-21-2022**

Buletini i Njoftimeve Publike [06.02.2023] [Nr. 12]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Kreatx” sh.p.k

NIPT: L12121023B

Vlera: 20,100,000.00 (njëzet milion e njëqind mijë) Lek pa TVSH.

2. “Tetra Solutions” sh.p.k

NIPT: K72017027P

Vlera: 21,743,000.00 (njëzet e një milion e shtatëqind e dyzetë e tre mijë) Lek pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Kreatx” sh.p.k

NIPT: L12121023B

Vlera: 20,100,000.00 (njëzet milion e njëqind mijë) Lek pa TVSH.

Arsyet e skualifikimit:

1. Në respekt të përmbushjes së kërkesës së pikës 2 të DST: Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1 (b), Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3, shihet që Sigurimi i Ofertës sipas Shtojcës 3 të paraqitur nga OE nuk është sipas kërkesave të DST, ka ndryshime.
2. Në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3 të DST, Kapaciteti teknik, e më saktësisht pika 2.3.1 e saj; në dokumentat provuese të sjella nga OE vërehet se:
 - Vërtetimi për realizim kontrate, Nr. 5666/15 Prot., datë 11.04.2022 ndërmjet OE dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për kontratën Nr. 5966/10 Prot., datë 22.01.2021 me objekt: Shërbim i mirëmbajtjes së programit financiar (Cloud) ka një mos-përputhje ndërmjet vlerës së shërbimit të shprehur në këtë vërtetim (3,582,000.00 lekë pa TVSH) me vlerën e shprehur në këtë kontratë të lidhur ndërmjet palëve që i referohet ky vërtetim (3,582,000.00 Lekë me TVSH) që i është bashkëngjitur kësaj procedure. Gjithashtu, në vijim të përmbushjes së kërkesave të kësaj pike, për këtë kontratë nuk janë paraqitur fatura/t tatimore të shitjes të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.
 - Kontrata e lidhur ndërmjet OE dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, Nr. 99/31 Prot., datë 24.05.2021 me vlerë 24,645,000.00 Lekë pa TVSH e me objekt: Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata nuk konsiderohet si kontratë e ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Objekti dhe natyra e kësaj kontratë flet për një sistem gjykate, ndërsa objekti dhe natyra e kësaj procedure prokurimi është e qartë së çfarë kërkohet; Blerje sistemi financiar, fiskalizim dhe fatura elektronike në Cloud së bashku me integrim me programin EMCS dhe fiskalizimi i faturave për tre vite, e cila është e ndryshme nga ajo që është sjellë.
 - Për kontratën e lidhur ndërmjet OE dhe Ujësjetës Kanalizime Durrës Sh.a., Nr. 4 Prot., datë 06.01.2020 me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve” me vlerë 6,900,00.00 lekë pa TVSH, OE, në vijim të përmbushjes së kërkesave të kësaj pike, për këtë kontratë nuk ka paraqitur fatura/t tatimore të shitjes të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.
 - Për kontratën e lidhur ndërmjet OE dhe OSHEE Sh.a., Nr. 9486/9 Prot., datë 09.07.2019 me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit ARMS” dhe vlerë 12,420,00.00 lekë pa TVSH, OE, në vijim të përmbushjes së kërkesave të kësaj pike, për këtë kontratë nuk ka paraqitur fatura/t tatimore të shitjes të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.
 - Për faturat tatimore të paraqitura me shitës OE dhe blerës si vijon: UK Vorë, UK Himarë, UK Përmet, UK Gjirokastrë dhe UK Kamëz, OE nuk ka bashkëngjitur vërtetimet e realizimit të këtyre kontratave ku të shënohen të dhënat e sakta siç kërkohet në këtë pikë që shyrtohet.

3. Në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3 të DST, Kapaciteti teknik, e më saktësisht pika 2.3.4 e saj ku Operatori ekonomik ofertues ndër të tjera duhet të ketë edhe certifikimet për Sisteme ERP Cloud dhe Infrastrukturë Cloud vërehet se:
 - Për të përmbushur këtë kërkesë për Sisteme ERP Cloud, OE, Operatori ka paraqitur disa screenshot-e nga Gartner Peer Insights web page. Në këtë faqe duket qartë që ka 1 review me 4 yje për Flare Accounting, dhe kjo është trajtuar si një konfirmim që Gartner-i e njeh këtë aplikim si një Cloud ERP. Qartësisht faqja Gartner Peer Insights është një faqe ku kushdo mund të shfaqë opinionin e vet pa ndonjë filtrim apo kontroll të detajuar nga Gartner, siç mund të shihet në link: <https://www.gartner.com/reviews/faq#rq1>, si e tillë nuk përbën asnjë lloj konfirmimi apo certifikimi nga Gartner. Ndërkohë arsyetimi vijon me faktin që operatori ofron kurse trajnimi profesional për zgjidhjen e tij dhe si rrjedhim automatikisht zgjidhja e propozuar është e certifikuar si Cloud ERP. Ky në të vërtetë është një “vetë-certifikim” dhe nuk përmbush kushtet për të konsideruar zgjidhje e propozuar si një Cloud ERP. Në të dy arsyetimet e mësipërme operatori ofron indicie indirekte përse zgjidhja e ofruar duhet të konsiderohet si e certifikuar “Cloud ERP”, por asnjë certifikatë konkrete. Në këto rrethana, konkluzioni është se zgjidhjes së propozuar i mungon certifikimi për “Sisteme ERP Cloud”.
 - Për të përmbushur këtë kërkesë për Infrastrukturë Cloud, OE, referon që është partner me kompaninë Cisco, por nuk ka paraqitur asnjë dokument për të qartësuar llojin e partneritetit duke i lënë të gjitha në një konfirmim nga faqja eeb cisco.com. Lloji i partneritetit nuk mund të verifikohet duke përdorur këtë metodë. Kjo është shumë e rëndësishme duke pasur parasysh që kompania Cisco ka disa nivele partneriteti duke filluar nga “Registered Partner” deri tek “Gold Partner”, megjithatë edhe nëse verifikohet niveli i partneritetit, ky i fundit nuk përbën certifikim për Infrastrukturë Cloud sepse në dokumentin “Channel Certification Program” nga Cisco : https://www.cisco.com/c/dam/global/de_at/assets/docs/cpp_cert_ds.pdf thuhet se: “Cisco certification demonstrates to your customers that your company maintains Cisco product knowledge and support; it also validates your company’s expertise in working with Cisco solutions as you design, deploy, and maintain customer networks”. Pra është e qartë që ky partneritet përligj vetëm një pjesë të kërkesave për “Infrastrukturë Cloud”. Sa i përket argumentimit Gartner dhe vetë-certifikimit të përmendur në deklaratë, sipas Gartner Peer Insights është një faqe ku kushdo mund të shfaqë opinionin e vet pa ndonjë filtrim apo kontroll të detajuar nga Gartner, siç mund të shihet në link: <https://www.gartner.com/reviews/faq#rq1>, si e tillë nuk përbën asnjë lloj konfirmimi apo certifikimi nga Gartner. Si konkluzion, OE i mungon certifikimi për “Infrastrukturë Cloud”.
4. Në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3 të DST, Kapaciteti teknik, e më saktësisht pika 2.3.7 e saj, vërehet që për këtë kërkesë të kësaj pike: Përgjigje një më një të kërkesave teknike të specifikuara në Termat e Referencës së sistemit, nuk përmbushen të dhënat si më poshtë:
 - Duke ju referuar Ofertës Teknike të dorëzuar nga OE, në pikën 2.1 të saj është specifikuar që: ***“Flare është i pavarur nga sistemi revolucionar për ruajtjen e të dhënave (RDBMS) dhe zgjedhja përfundimtare do të bëhet gjatë fazës së analizës dhe komunikimit me AK.***

Për monitorimin e RDBMS mund të përdorim zgjidhje të gatshme si psh Navicat Monitor, zgjidhje enterprise ose zgjidhje të zhvilluar nga vet Kreatx e cila gjithashtu plotëson të gjithë kriteret e kërkuara prej AK, etj..”, ndërkohë që tek kërkesat në ToR nuk ka fazë analize, por duke ju përgjigjur të gjithë kërkesave një më një siç edhe kërkohet në këtë pikë kërkohet një përgjigje e saktë dhe e argumentuar me zgjidhjet e ofruara nga OE që në momentin e ofertimit.

- Në përgjigje të kërkesës në ToR dhe më saktësisht tek ***“administrimi i të ardhurave dhe klientëve”*** është kërkuar që: *Duhet që të ketë strukturë të mirëfilltë zbritjesh për klient, për kategori produkti, ose grup klienti*, ndërkohë që në ofertën teknike të OE në pikën 3.1.3 të saj nuk i është përgjigjur në mënyrë të qartë kësaj pike siç edhe kërkohet në këtë pikë (2.3.7), përgjigje një më një e të gjitha kërkesave.
- Në përgjigje të kërkesës në ToR dhe më saktësisht tek ***“administrimi i të ardhurave dhe klientëve”*** është kërkuar që: *Të ekzistojë mundësia e konvertimit të tyre në furnitor ose klient*, ndërkohë që në ofertën teknike të OE në pikën 3.1.3 të saj nuk i është përgjigjur kësaj pike siç edhe kërkohet në këtë pikë (2.3.7), përgjigje një më një e të gjitha kërkesave.
- Në përgjigje të kërkesës në ToR dhe më saktësisht tek ***“administrimi i shpenzimeve dhe furnitorëve”*** është kërkuar që: *Sistemi duhet të lejojë llogari të shumëfishta bankare për pagesat duke përfshirë llogaritë e këmbimit valutor*, ndërkohë që në ofertën teknike të OE në pikën 3.1.4 të saj nuk i është përgjigjur kësaj pike siç edhe kërkohet në këtë pikë (2.3.7), përgjigje një më një e të gjitha kërkesave.
- Në përgjigje të kërkesës në ToR dhe më saktësisht tek ***“administrimi i shpenzimeve dhe furnitorëve”*** është kërkuar që: *Sistemi duhet të lejojë rivlerësimin e balancave të furnitorit. Sistemi duhet të suportoje mbajtjen e kurseve të ndryshme të këmbimit nga kurset e sistemit për rivlerësimet e furnitorëve*, ndërkohë që në ofertën teknike të OE në pikën 3.1.4 të saj nuk i është përgjigjur kësaj pike siç edhe kërkohet në këtë pikë (2.3.7), përgjigje një më një e të gjitha kërkesave.
- Në përgjigje të kërkesave të ToR dhe më saktësisht për pikën 10.8 të saj ***“Përgjigjja si dhe përshkallëzimi i shërbimit”*** OE nuk i është përgjigjur këtyre pikave siç edhe kërkohet në këtë pikë (2.3.7), përgjigje një më një e të gjitha kërkesave.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **Tetra Solutions sh.p.k**, me **NIPT K72017027P**, me adresë Rruga “Gjin Bue Shpata”, Pallati 2/1, Ap.2 Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 21,743,000.00 (njëzet e një milion e shtatëqind e dyzetë e tre mijë) Lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **ALPEX sh.a** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JO ☐

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

SOKOL DISHNICA